REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR FURNIZIM

***KOMUNA E ISTOGUT** në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Gëzim Ademaj, U.D. i menaxheit të Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;*

Dhe

"PBC" Sh p k Komuna e Prishtinës, të cilën e perfaqëson z. Bashkim Selmanaj, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810845985 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

SISTEMI ELEKTRONIK PËR ADMINISTRIMIN E SUBVENCIONEVE KOMUNALE

Nr. I prokurimit	*633-020-4620-1-3-6/C411*
Nr. I brendshëm	*633 / 020 / 062-136*

Neni 1 Lënda
Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: SISTEMI ELEKTRONIK PËR ADMINISTRIMIN E SUBVENCIONEVE KOMUNALE

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i furnizimeve per aktivitetin e prokurimit:

SISTEMI ELEKTRONIK PËR ADMINISTRIMIN E SUBVENCIONEVE KOMUNALE është ; 2.360,00 € dhe me fjalë:
/Dymijëetreçindegjashtëdhjetë/ €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit te kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Afati I dergesës

3.1Kontraktori është I obliguar qe mallrat ti dorëzojë ne afatin prej 10 ditësh, nga data e nënshkrimit te kontratës, ne të kundërten kontrata do të ndërpritet, dhe pasojat e shkëputjës do ti bartë kontraktori.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet e detyrueshme Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës
Igjith dokumentacioni percjelles I dosjes se tenderit.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për: Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për: Kontraktuesin:
"PBC" Shpk

Emri:	***Gëzim Ademaj***	***Emri:***	***Bashkim Selmani***
Pozita:	***U.D.*** ***I Menaxheri-it të Prokurimit***	***Pozita:***	***D r e j t o r***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	10/12/2020	***Data:***	10/12/2020
Vu la		***V u l a***	

KOMUNA E ISTOGUT					
Sistemi elektronik për Administrimin e Subvencioneve Komunale					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
	Specifikimi i punëve	**Njësia (1)**	**Sasia (2)**	**Cmimi/ Njesi (3)**	**Gjithsejt (2x3)**
1	**Kërkesat softuerike**				
1.1	Zhvillimi dhe vendosja në përdorim e softuerit për administrimin elektronik të Subvencioneve Komunale. Softueri duhet të jetë web aplikacion. Funksionaliteti i softuerit duhet jetë i bazuar në dokumentin e hartuar nga komuna lidhur me Specifikimin e Kërkesave të Shfrytëzuesve. Para zhvillimit të sofuerit, duhet të merret miratimi i komunës lidhur me Use Case-at e softuerit. Sofueri duhet të vendoset dhe konfigurohet në një server të komunës dhe një kopje e kodit burimor, e vendosur në CD, duhet t'i dorëzohet komunës. Duhet hartuar në formatin .pdf udhëzuesin e përdorimit të aplikacioni dhe i njëjti duhet të jetë i integruar në aplikacion ashtu që përdoruesit të kenë qasje të lehtë në informatat e udhëzuesit. Garancioni i funksionimit të softuerit duhet të jetë një vit.	pako softuerike	1	2360	2,360.0 €
	TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT				**2,360.0 €**